



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:019323

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05694976

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr. 29/24

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti, dhe bashkëpunëtorin profesional Muhamet Musliu, në çështjen penale ndaj të pandehurit V. G., për shkak të veprës penale Kanosje neni 181 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.112/2024 të datës 26.01.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 16.05.2024, në të cilin ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit Menduhi Kastrati, i dëmtuari E. M. si dhe i pandehuri me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av. G. N. nga P., në të njëjtën ditë mori, publikisht shpalli dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

V. G. i lindur me ... në P., me banim në rr. Ll.-P., nga i ati H. dhe e ëma Z., e gjinisë Zh., i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer fakultetin, instruktor në “auto shkollën A.”, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE

Ekziston dyshimi i bazuar mire se me datë 25.12.2023, rreth orës 17:15, në P. saktësisht në rr. “N. G. dhe 19 Q., i pandehuri V. G., me qëllim të shkakimit të frikësimit dhe ankthit seriozisht e kanos me fjalë personin zyrtar në lidhje me punën e tij, dhe atë dëmtuarin zyrtarin policor E. M., në atë mënyrë që ditën kritike deri sa i dëmtuari ishte në kryerjen e detyrës zyrtare, se bashku me kolegun e tij B. S. duke shqiptuar fletëparaqitje për kundërvajtje për parkingje të parregullta të pandehurit V. G. i cili posedonte veturën VW G., ngjyre hiri me targa ..., ky i fundit pas shqiptimit të gjobës nga i dëmtuari, e fyer dhe kanos të dëmtuarin me fjalët “Çka ke ti me mua, ti djalë ke me pas pune private dhe personalisht me mua”, me ç ‘rast i pandehuri me veprimet e tij tek e dëmtuari ka shkakuar frik, ankth dhe pasiguri për jetën e tij.

- Me këto veprime, i pandehuri ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 par.3 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 2, 4, 7, 8, 9, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe nenit 181 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 242, 364, 365, 368, 369, 449, 452 dhe 462 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

I. Të akuzuarin me dënim me burgim kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, të cilin dënim do ta vuaj brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

II. Konform nenit 44 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumën prej 600€ (gjashtë qind/euro), të cilin dënim duhet të paguaj brenda afatit prej 15 ditë, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, e në rast se nuk e paguan atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 (njëzet) euro të papaguara do t'i llogaritet 1 (një) ditë burgim, konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

III. Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, për paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

IV. I dëmtuari E. M. nga fshati G. komuna e P. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP/II.nr.112/2024 të datës 26.01.2024, kundër të pandehurit V. G., për shkak të veprës penale Kanosje neni 181 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar më datë 16.05.2024, gjatë të cilës u dëgjuan Prokurori i Shtetit Menduhi Kastrati, i dëmtuari E. M. si dhe i pandehuri me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av. G. N.

I pandehuri pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit deklaroi: se e pranoj fajësinë, i kërkoj falje të dëmtuarit, nuk kam pasur asnjë qëllim ndaj policit sepse nuk e kam njohur më herët dhe se nuk do të kem problem me të asnjëherë, e lus gjykatën që të më shqiptoi një dënim sa më të lehtë, jam mbajtës i familjes gjashtë anëtarshë, ky rast nuk do të përsëritet më.

Mbrojtësi i të pandehurit sipas autorizimit av. G. N. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi: E mbështes dhe pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim i cili pranim është bërë pas konsultimit të mjaftueshëm dhe pas shikimit të shkresave të lëndës, i propozoj gjykatës që gjatë matjes së dënimit të i marrë parasysh rrethanat lehtësuese e të cilat besoj se janë në shkresat e lëndës. Gjykatën e ftoj që të shoh edhe raportin e oficerit i cili ishte prezent në vendin e ngjarjes, zyrtarin Policor. Po ashtu i propozoj gjykatës një dënim sa më të lehtë në kuadër të suazave ligjore, të parapara në zbutjen e dënimeve. Të mbrojturit tim të i shqiptoi një dënim me gjobë për aq sa di[pozitat e zbutjes së dënimeve e lejojnë, i njëjti është

mbajtës i familjes dhe nuk ka qenë i dënuar më parë. Si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë, dhe kërkim falja të dëmtuarit.

I dëmtuari lidhur E. M. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi: I bashkëngjitem ndjekjes penale, nuk kërkoj kompensimin e dëmit, mbetem pran asaj që kam thënë në raportin e policisë.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi: Pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit sepse i njëjti është bërë me vullnetin e plotë nga i pandehuri dhe bazuar në shkresat e lëndës. Me rastin e shqiptimit të dënimit të merren si rrethana lehtësuese pranimi i fajësisë, shprehja e keqardhjes ndaj veprimit që ka ndërmarr ndaj të dëmtuarit, është mbajtës i familjes, ka të kryer shkollimin superior, si dhe nga evidenca policore nuk ka vepër të kryer penale, ndërsa po ashtu i propozoj gjykatës të i marrë parasysh si rrethanat lehtësuese po ashtu edhe ato rënduese sipas ligjit.

Gjyqtari i vetëm gjykues konstaton se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban Aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i Shtetit, dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga i akuzuari, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 242 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga vet të akzuarit, gjykata vlerëson se në veprimet inkriminuese të akzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Rrezikim i trafikut publik neni 181 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është përgjegjës dhe të njëjtin e shpalli fajtor, andaj i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, i ka kërkuar falje të dëmtuarit, ka premtuar se më nuk do të përsëris veprime të tilla, ndërsa si rrethanë veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Andaj gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandalojë nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me burgim në dënim me gjobë është marr në kuptim të nenit 44 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 43 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par. 2 pika 2.6 dhe 2.9 të KPPRK-së.

Vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë, konform nenit 36 par.3 nën par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontestin civil është marrë në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.29/24 me dt.16.05.2024

Sekretare juridike
Fatmire Podvorica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Minir Hoti

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj Gjykate.